

#### SHKURTESA

|        |  |
|--------|--|
| SHA    | Shoqata Aksionare  |
| PAMJAS | Plani i Aksionit për Mjedisin Jetësor dhe Aspektet Sociale     |
| KR     | Kërkesë për realizim   |
| QRMV   | Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut                   |
| OQ     | Organizatrat Qytetare  |
| BERZH  | Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim                     |
| ENMJ   | Elaborat për Ndikim mbi Mjedisin Jetësor                       |
| EMMJ   | Elaborat për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor                      |
| NJZP   | Njësia për Zbatimin e Projektit                                |
| EMV    | Elektranat e Maqedonisë së Veriut                              |
| BE     | Bashkimi Evropian  |
| PPP    | Persona të përfshirë nga projekti                              |
| MW     | Megavat/ë  |
| OJQ    | Organizata Joqeveritare  |
| PJT    | Përmbledhje jo-teknike   |
| VNMJ   | Vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor                      |
| VNMJAS | Vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor dhe aspektet sociale |
| PPPI   | Plani për përfshirjen e palëve të interesuara                  |
| PMJAS  | Politika për mjedis jetësor dhe aspekte sociale                |
| REK    | Kombinati Energjetik i Minierave                               |
| RM     | Republika e Maqedonisë   |
| GZ     | Gazeta Zyrtare   |
| FV     | Fotovoltaik/e  |
| EFV    | Elektrana fotovoltaike   |
| CTE    | Centrali termo-elektrik  |

## 1 HYRJE

### 1.1 DISPOZITAT

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) e shqyrton mundësinë për sigurimin e mjeteve financiare të Ndërmarrjes publike për prodhimin e energjisë elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, SHA Shkup ("EMV" ose "Projekti") e Republikës së Maqedonisë së Veriut për financimin e ndërtimit të elektranës së dytë fotovoltaike (EFV) nga 10 MW (Projekti ose Osllomej 2) në hapësirat e Termoelektranës ekzistuese Osllomej, afër EFV-së në zhvillim EF Osllomej-1, në komunën e Kërçovës, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Duke marr parasysh vëllimin dhe natyrën e Projektit, në kuadër të Politikës për Mjedisin Jetësor dhe Aspektet Sociale për 2019, BERZH projekti e kategorizon si Projekt i Kategorisë B.

Ky plan për përfshirjen e palëve të interesuara (PPPI) i përshkruan aktivitetet që ndërmerren në fazë të planifikimit të Projektit, faza e ndërtimit dhe e operimit. Ky dokument është i përgatitur së bashku me Përmbledhjen jo-teknike (PJT) të Vlerësimit të ndikimit mbi mjedisin jetësor dhe aspektet sociale (VNMJAS) dhe Planin i Aksionit për Mjedisin Jetësor dhe Aspektet Sociale (PAMJAS) të përgatitura për nevojat e Projektit.

### 1.2 Qëllimet dhe përfshirja e Planit për përfshirjen e palëve të interesuara

Ky PPPI ishte përgatitur me qëllim të vërtetojë programin për përfshirjen e palëve të interesuara që duhet të zbatohet gjatë tërë ciklit projektues.

Qëllimi i këtij PPPI është të përmirësohet dhe lehtësohet procesi i krijimit të vendimeve të lidhura me Projektin, të krijojnë mundësi për përfshirje aktive dhe në kohë, për të gjitha palët e interesuar si dhe të sigurojë mundësi që këto të mund të shprehin mendimin e tyre dhe kujdesin që do të mund të ndikojnë në vendimet projektuese. Qëllimi i PPPI është të përforcohet përfshirja e palëve të interesuara gjatë tërë ciklit të Projektit, dhe të zbatohet përfshirja e palëve të interesuara në pajtim me ligjet maqedonase, si dhe në pajtim me kërkesat e BERZH-it.

PPPI do të rishikohet, ndërsa nëse është e nevojshme të përditësohet në nivel vjetor, ndërsa në drejtim të mbetet relevant për vetë statusin e Projektit, si dhe për nevojat e palëve të interesuara.

## 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Si rezultat i **Strategjisë Nacionale për Zhvillimin e Energjetikës deri në vitin 2040** ku janë të definuara qëllimet për përdorimin e rritur të burimeve të rinovuara në prodhimtarinë dhe konsumin e energjisë elektrike deri në vitin 2030 (deri 33%), në pajtim me BE-në dhe Komunitetin Energjetik, EMV e zhvilloi projektin për ndërtim të elektranës së dytë fotovoltaike (EDF) në Osllomej me 10 MW, për shfrytëzimin e energjisë diellore e cila është gjerësisht e qasur në atë pjesë të vendit.

Është planifikuar që EFV Osllomej 2 të ndërtohet si vazhdimësi e EFV Osllomej 1. Ajo duhet të ndërtohet në tokën në pronësi të EMV-së, e cila është në distancë të vogël nga nënstationet dhe infrastrukturën rrugore, ndërsa në afërsi të termoelektranës operative Osllomej, me çka sigurohet qasja deri te fuqia e trajnuar e punës. Projekti do ta rehabilitojë tokën e shkatërruar nga aktivitetet e lidhura me shtyrjen e mbetjeve të minierës për lignit. Projekti do të mundësojë ri përdorimin e tokës momentale së pashfrytëzuar industriale.

Lokacioni i Projektit gjendet në rrethinën e fshatit Osllomej, në pjesën perëndimore të Maqedonisë. Qyteti më i afërt është Kërçova, i vendosur rreth 7 km në jug-perëndim nga lokacioni i Projektit. Vendbanimet më të afërta janë fshati Osllomej (përafërsisht 1 km në veri-perëndim nga parcela e EFV), Zhubrinë (përafërsisht 2 km në veri-lindje), Sërbicë (përafërsisht 2,5 km në veri-lindje) dhe Shutovë (përafërsisht 2 km në jug-lindje).




Figura 1: Harta e vendbanimeve që e definojnë fushën e projektit

**Commented [41]:** MK - ALB

- Oslomej – Oslomej
- Жубрино – Zhubrinë
- Србица – Sërbicë
- Премка – Premkë
- Шутово – Shutovë
- Гарани – Garanë
- Стрелци – Strellcë
- Црвивци – Crvivci
- Џамбазово Брдо – Kodra e xhambazit
- Чука – Çukë
- Рудник Ослемеј Исто – miniera Oslomej lindje

### 3 KORNIZA JURIDIKE DHE POLITIKE PËR PËRFSHIRJEN E PALËVE TË INTERESUARA

#### 3.1 Legjislacioni kombëtar për përfshirjen e palëve të interesuara

Kërkesat për shpallje publike dhe aktivitete konsultative të lidhura me përgatitjen e dokumentimit projektues dhe studime të tjera të lidhura strategjike me këto ligje:

- **Ligji për planifikimin hapësinor dhe urbanistik** (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16) - e rregullon sistemin e zhvillimit hapësinor dhe urban të Maqedonisë, duke përfshirë edhe informimin dhe pjesëmarrjen e opinionit në procesin e zhvillimit dhe miratimit të dokumentacionit për planifikim urban dhe hapësinor.
- **Ligji për mjedisin jetësor** (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15, 39/16, 99/18). Ky ligj dhe rregullat e bashkëngjitura nënligjore e vërtetojnë nevojën për përpunimin e Vlerësimit të Ndikimit mbi Mjedisin Jetësor (VNMJ) për ndikimin e mundshëm mbi mjedisin jetësor të projektit publik dhe privat, për të cilët pritet të kenë ndikim të rëndësishëm mbi mjedisin jetësor para se të lëshohet leja e ndërtimit në kuptim të lejes për lëshimin e projektit.

Në përgjithësi, procedurat për debatet publike dhe konsultimet i përmbajnë hapat në vijim:

- Opinioni është informuar për detajet e diskutimeve publike për draft planin/dokumentin (lokacioni i mostrës, si dhe koha kur mund inspektimi të kryhet) përmes medimeve, ku edhe qytetarët/organizatat janë të ftuara të japin komente dhe/ose të marrin pjesë në debatet publike;
- Debatet publike, ku plani/dokumenti prezantohet, mbahen në hapësirë përkatëse publike (p.sh., hapësira komunale, salla të këshillit të komunave);
- Komentet nga të gjitha palët e interesuara janë të pranuar dhe të proceduara, dhe plani/dokumenti është rishikuar për t'i përmbajtur edhe ata. Raporti, me arsyetim për komentet e pranuar dhe të refuzuara, së bashku me planin/dokumentin e skicës të dorëzuar deri te organet relevante që vlerësojnë nëse komentet janë shqyrtuar dhe miratuar me kujdes;
- Të gjitha komentet marrin përgjigje në formë të shkruar.

Opinioni duhet të përfshihet në çdo katër hapa gjatë realizimit të procedurave të VNMJ dhe të gjitha vendimet të sjellura në procesin duhet të publikohen në medimet përkatëse. Dokumentet në vijim do të shpallen publikisht:

- Njoftim për qëllimin e zbatimit të projektit;
- Vendim për Skrining dhe vërtetimin për diapazonin e VNMJ;
- Publikim për qasje të Elaboratit për mbrojtje të mjedisit jetësor (EMMJ);
- Vendim i MMJPH për pranimin e kërkesës ose refuzimin e kërkesës për zbatimin e projektit.

Ligjet e tjera të zbatueshme që parashikojnë publikimin e informacioneve për projektin ose qasjen deri te informacionet përfshirë edhe mekanizmin për ankesa janë:

- Ligji për ndërtim (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 130/09, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 70/13, 79/13, 137/13, 150/13, 163/13, 27/14, 28/14, 42/14, 115/14, 149/14, 187/14, 44/15, 129/15, 30/16, 31/16, 39/16, 71/16, 132/16 dhe 35/18)
- Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 13/06, 86/08, 06/10, 42/14, 148/15)
- Ligji për shqyrtimin e ankesave dhe kontesteve (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/08, 13/13, 156/15, 193/15).

Në vitin 1999, Maqedonia e nënshkroi kushtet e Konventës së Arhusit për qasje të informacioneve, pjesëmarrje të publikut në sjelljen e vendimeve dhe qasje deri te drejtësia për pyetje të lidhura me mjedisin jetësor (1998). Konventa e Arhusit i garanton të drejtat e publikut në lidhje me qasjen deri te informacionet, pjesëmarrja e publikut dhe qasja deri te drejtësia, në proceset për sjelljen e vendimeve të qeverisë për çështje të lidhura me

lokale, nacionale dhe mjedisit jetësor tejkufitarë. Kështu, fokusi është vendosur në bashkëveprim midis publikut dhe autoriteteve.

### 3.2 Politika e BERZH për mjedisin jetësor dhe aspektet sociale

BERZH ka pako gjithëpërfshirëse të Kërkesave specifike për paraqitje (KP) që priten projektet të plotësohen. KP 10 (Publikim i informacioneve dhe përfshirje e palëve të interesuara) nga Politika për Mjedisin Jetësor dhe Aspektet Sociale (PMJAS) 2019 të BERZH, e thekson rëndësinë e përfshirjes së hapur dhe transparente midis projektit, të punësuarit e tyre, komunitetet lokale drejtpërdrejtë të përfshirë nga projekti dhe palët e tjera të interesuara si element thelbësor i praktikave të mira ndërkombëtare të pranuar dhe shtetësisë së korporatës. Përfshirja e palëve të interesuara përfshin identifikimin dhe analizën e palëve të interesuara, planifikimin e përfshirjes së palëve të interesuara, publikimin e informatave, konsultimeve dhe pjesëmarrjes, mekanizmin e ankesave, dhe njoftimin aktual të palëve relevante të interesuara.

Në përputhje me KP 10, nga projektet kërkohet të përgatisin dhe zbatojnë Planin për përfshirje të palëve të interesuara të përshtatura në natyrën dhe diapazonin e rreziqeve, ndikimet dhe fazën zhvilluese të projektit, dhe të zbatojnë përfshirjen e palëve të interesuara në bazë të sigurimit të qasjes deri te informacionet e qasshme në kohë, relevante, të kuptueshme për komunitetet lokale që janë drejtpërsëdrejti të përfshira nga projekti, si dhe për palët e tjera relevante të interesuara.

BERZH kërkon bartësit e projekteve të krijojnë dhe mbajnë mekanizëm efikas për ankesa, pastaj duke u kujdesur për të gjitha ankesat të shprehura nga palët e interesuara, miratohen, përpunohen dhe zgjidhen në mënyrë efikase, të shpejtë dhe në kohë.

## 4 IDENTIFIKIMI I ANALIZAVE TË PALËVE TË INTERESUARA

Palët kryesore të interesuara që duhet të informohen dhe konsultohen për Projektin janë:

- a) Të përfshirë ose me siguri do të përfshihen nga projekti (palët e përfshira nga projekti); dhe
- b) Mund të kenë interes nga Projekti (palët e interesuara).

### 4.1 Identifikimi i palëve të interesuara të projektit

Tabela në vijim e paraqet mënyrën e identifikimit dhe analiza e qasjes së komunikimit me palët e veçanta të interesuara.

**Tabela 1** Analiza e palëve të interesuara dhe kërkesa për komunikim

| Palë e interesuar e identifikuar   | Pyetje të veçanta ose interesa   | Qëllimi i përfshirjes dhe komunikimi                               | Lloji dhe mënyra e komunikimit   |
|--|--|--|--|
| <b>Palët e interesuara nga Projekti</b>  |  |  |  |
| <b>Popullsia lokale</b> e cila jeton në vendbanimet e Projektit (distancë ajrore deri 3 km) ose në fushë më të gjerë të Projektit (më shumë se | Interes potencial për pyetje nga fusha e shëndetësisë, sigurisë dhe shqetësimit lidhur | Sigurimi i informacioneve në kohë për rreziqet dhe çrregullimet që | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Mediumet sociale Onlajn (Facebook, YouTube, Instagram), Ueb faqet zyrtare, Viber, WhatsApp dhe të tjera.</li> </ul> |

| Palë e interesuar e identifikuar  | Pyetje të veçanta ose interesa  | Qëllimi i përfshirjes dhe komunikimit  | Lloji dhe mënyra e komunikimit   |
|---|---|--|--|
| 5 km), dhe që i ndjehen efektet e aktiviteteve të ndërtimit dhe operative lidhur me Projektin. Vendbanimet janë:<br>a) Deri 3 km: Garanë, Zhubrinë, Oslomej, Premkë, Sërbicë, Strellcë, Cërvicë dhe Shutovë<br>b) Më shumë se 3 km: Qafë, Papradishti (Çashkë), Berikovë, Jagoll, Dollencë, Tuhin, Popojan, Haranjell, dhe Novo Sellë | me projektin<br><br>Prishje e rutinës ditore dhe rrugët për lëvizje të njerëzve | janë të lidhura me fazën e ndërtimit dhe operative   | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Publikimi i informacioneve në tabelë publike për diapazonin, kohën dhe kohëzgjatjen e aktiviteteve të planifikuara, si dhe të gjitha shqetësimet dhe shqetësimet që mund të dalin nga aktivitetet e projektit, në tre komunat e përfshira dhe atë dy javë së paku para fillimit të çfarë do lloj aktiviteti ndërtimor dhe një javë para fillimit të çfarë do lloj ndryshimi i rëndësishëm në fazën e ndërtimit që është me rëndësi të veçantë në fazën e ndërtimit që është me rëndësi të veçantë për popullsinë lokale.</li> </ul> |
| <b>Komuna e Kërçovës</b>  | Interesim për projektin zhvillues, shëndetin dhe sigurinë e popullsisë lokale   | Sigurimi i informacioneve në kohë për rreziqet dhe shqetësimet që lidhen me fazën e ndërtimit dhe të operimit    | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Materiale në internet për prezantim.</li> <li>▪ Medieme/kumtesa për shtyp</li> <li>▪ Takime konsultuese publike, në qoftë se është e mundur</li> <li>▪ Komunikim i drejtpërdrejtë përmes email-it dhe telefonit</li> <li>▪ Mediumet sociale (Facebook, YouTube, Instagram), ueb faqe zyrtare, Viber &amp; WhatsApp dhe të tjera.</li> </ul>   |
| <b>Palë të tjera të interesuara</b>   |   |  |  |
| <b>Opinion</b> në komuna të përfshira   | Ekzistimi i aktiviteteve ndërtimore lidhur me Projektin.                        | Sigurimi i informacioneve në kohë për përfitimet dhe rreziqet nga Projekti.                                      | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Materiale në internet për prezantim.</li> <li>▪ Medieme/kumtesa për shtyp</li> <li>▪ Takime për konsultime publike/nëse është e mundur</li> <li>▪ Komunikim i drejtpërdrejtë përmes email-it dhe telefonit</li> <li>▪ Mediumet sociale (Facebook, YouTube, Instagram), Ueb faqet zyrtare, WhatsApp, Viber dhe të tjera.</li> </ul>  |
| <b>Organe qeveritare relevante, ministri dhe institucione publike</b> përfshirë:<br><br><ul style="list-style-type: none"> <li>• Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit</li> </ul>   | Lëshimi i licencave, në pajtim me mendimet me legjislativon kombëtar            | Konsultime me institucione qeveritare relevante në lidhje me aktivitetet e Projektit në kuadër të procedurave të | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Takime individuale Onlajn, sipas nevojës</li> <li>▪ Takime publike për konsultime</li> <li>▪ Komunikimi i drejtpërdrejtë përmes e-postës dhe telefonit</li> </ul>   |

| Palë e interesuar e identifikuar  | Pyetje të veçanta ose interesa   | Qëllimi i përfshirjes dhe komunikimi  | Lloji dhe mënyra e komunikimit   |
|---|--|---|--|
| <p>Hapësinor</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ministria e Financave</li> <li>Ministria e Transportit dhe Lidhjeve</li> <li>Ministria e Punës dhe Politikës Sociale</li> <li>Ministria e Ekonomisë</li> <li>Inspektorati Shtetëror i Punës</li> <li>Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor</li> <li>Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave</li> <li>Komisioni Rregullator për Energjetikë</li> <li>Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim</li> </ul>  |  | <p>lejuara.</p> <p>Njoftim i bazuar në kërkesën e legjislacionit kombëtar</p>                 |  |
| <p><b>Organizatat joqeveritare të interesuara (OJQ, për shembull nga mjedisi jetësor, fusha sociale)</b></p> <p>Të gjitha organizatat që ende nuk kanë treguar interes specifik për Projektin, do t'ju mundësohet t'i paraqesin mendimet e tyre ose pyetjet gjatë përgatitjes dhe zbatimit të Projektit.</p> <p><b>Vërejtje:</b> Të gjitha organizatat që janë të interesuara për Projektin mund t'i dërgojnë detajet e veta për kontakt deri NJZP me qëllim të organizatave joqeveritare të dhëna në Shtojcën 4 e PPPI dhe të njoftohen drejtpërdrejtë për ngjarjet e Projektit.</p> | <p>Palët e interesuara që janë me rëndësi të madhe për suksesin e Projektit, që janë të interesuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe shëndetin e njeriut.</p>                        | <p>Sigurimi i informacionit në kohë, komunikim dhe konsultim.</p>                             | <ul style="list-style-type: none"> <li>Takime individuale në internet sa është e nevojshme. Takime publike për konsultim nëse është e mundur</li> <li>Komunikim i drejtpërdrejtë me e-postë dhe telefon</li> <li>Mediume / kumtesa për shtyp</li> <li>Mediume sociale (Facebook, YouTube, Instagram), Official website, Viber &amp; WhatsApp dhe të tjera.)</li> <li></li> </ul> |
| <p><b>EMV (dhe NJZP)</b> si dhe sindikatat relevante dhe organizatat e punëtorëve</p>   | <p>Palët e interesuara që kanë rëndësi të madhe për suksesin e Projektit, ndërsa janë të përfshirë drejtpërdrejtë ose indirekt në procesin e planifikimit dhe zbatimit të Projektit.</p> | <p>Sigurimi i informacioneve në kohë në lidhje me aktivitetet e planifikuara të projektit</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>kanale të EMV për komunikim intern</li> </ul>   |
| <p><b>Kontraktorët</b> ose nënkontraktorët</p>  | <p>Palë të interesuara që</p>  | <p>Sigurimi i Kodit të</p>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>Informacione përmes</li> </ul>  |

| Palë e interesuar e identifikuar  | Pyetje të veçanta ose interesa  | Qëllimi i përfshirjes dhe komunikimi   | Lloji dhe mënyra e komunikimit  |
|---|---|--|---|
| gjatë kohës së ndërtimit, përcjelljes dhe mbikëqyrjes së punëve, punëtorëve si dhe punëtorëve lidhur me mirëmbajtjen.   | kanë rëndësi të madhe për suksesin e Projektit, ndërsa janë të përfshirë drejtpërsëdrejti ose indirekt në procesin e planifikimit dhe zbatimit të Projektit.                            | Mirësjelljes së Projektit, dhe rregulla për siguri dhe shëndetësi gjatë punës, standarde për mbrojtjen e mjedisit jetësor  | <p>procedurës së tenderit dhe marrëveshje</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Komunikimi përmes inxhinierëve të mbikëqyrjes</li> <li>▪ Takime praktike te kantieri i ndërtimit me biseda për tema të sigurisë dhe shëndetit gjatë punës.</li> <li>▪ Raporte mujore për avancimin e punës që duhet t'i dorëzojnë kontraktorët gjatë kohës së punëve</li> <li>▪ Trajnime</li> <li>▪ Komunikim përmes e-postës</li> </ul> |
| <p><b>Biznese</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregti dhe shitje me pakicë</li> <li>• Transport</li> <li>• Faktorë të tjerë nga sektori privat</li> </ul> | Përfshirje në zhvillimin e aktiviteteve të projektit dhe përkatëse në nevojat e tyre dhe kapacitetet  | Biznese të informuara që do të duhet ta përshtatin punën e tyre dhe investimet e rezultateve të planifikuara të projektit. | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Takime individuale Onlajn, sipas nevojës. Takime publike të konsultimit nëse është e mundur</li> <li>▪ Komunikim i drejtpërdrejtë e-postë</li> <li>▪ Medieme/kumtesa për shtyp</li> </ul>  |
| <p><b>Donator dhe organizata të tjera ndërkombëtare</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të tjera</li> </ul>  | Palë të interesuara që kanë rëndësi të madhe për suksesin e Projektit dhe janë të përfshirë drejtpërsëdrejti ose indirekt në planifikimin e Projektit dhe financimin e zbatimit të tij. | Realizimi i mbështetjes dhe financave  | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Medieme/ kumtesa për shtyp</li> <li>▪ Medieme sociale (Facebook, YouTube, Instagram), Official website, Viber &amp; WhatsApp</li> <li>▪</li> </ul>   |

#### 4.2 Individë ose grupe të rrezikuara/prekura

Personat më të vjetër janë të pranishëm në fushën projektuese. Ekziston migrim i vazhdueshëm i popullsisë së re nga vendbanimet më të vogla në fushën e projektit, drejt qendrave të mëdha urbane në vend (migrimi rural-urban) ose jashtë vendit. Personat më të vjetër mbeten të jetojnë në vendbanimet e vendosur në afërsi të lokacionit të Projektit.

### 5 PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E AKTIVITETEVE TË MËPARSHME PËR PËRFSHIRJEN E PALËVE TË INTERESUARA

Meqenëse në afërsi të projektit, projekti EFV i ngjashëm është në fazë të zhvillimit (EFV Oslomej 1), palët e interesuara do të përfshihen nga fillimi i fazës së planifikimit të projektit.

Për projektin EFV Oslomej 1, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve organizoi konsultime publike më 23.09.2020, në hapësirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës. Njoftimi për zbatimin e konsultimeve ishte publikuar në dy gazeta ditore, në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe, më 14.09.2020.



Në lidhje me aktivitetet për përfshirje të palëve të interesuar, për projektin EFV Oslomej 1, ishte realizuar renditja vijuese e aktiviteteve:

- 12.08.2020 - Forma e ankesave për projektin dhe fletushka e ankesave, si dhe përmbledhje jo-teknike (PJT) për Vlerësimin e ndikimeve mbi mjedisin jetësor dhe aspektet sociale, u dërguan deri te palët e interesuara sipas PPPI (versionin anglisht, maqedonisht, shqip dhe turqisht)
- 12.08.2020 –Të gjitha dokumentet relevante u publikuan në ueb-faqen e EMV-së
- 14.08.2020 - e-posta deri te të gjitha palët e interesuara me të gjitha informacionet relevante dhe dokumentet
- 14.09.2020 –Ftesë për konsultim publik
- 23.09.2020 - Konsultime publike dhe publikime të informatave për projektin.

Aktivitetet për përfshirjen e të interesuarve, si dhe publikimi i dokumentacionit përkatës dhe informacionet për Oslomej-1 do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Për Oslomej-2, EMV ende nuk ka filluar aktivitetet për përfshirjen e palëve të interesuara. Për projekte që kanë rëndësi më të vogël të ndikimit mbi mjedisin jetësor dhe aspektet sociale dhe rreziqet, qeveria parashikon krijimin e VNMJ/Elaborat për ndikimin mbi mjedisin jetësor. Legjislacioni kombëtar nuk parashikon shpallje publike dhe konsultime për raportet e hollësishme të VNMJ-së. Sidoqoftë, EMV e publikoi Elaboratin për VNMJ, së bashku me Miratimin e Elaboratit për VNMJ të lëshuar nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor për EFV Oslomej-2 në ueb-faqen e vet, ku në këtë fazë është vetëm në gjuhën maqedonase.

## 6 PROGRAM PËR PËRFSHIRJEN E PALËVE TË INTERESUARA

### 6.1 COVID-19

Padyshim se pandemia COVID-19 i ndryshoi metodat e përdorura të njohura dhe të gjera për publikim të informatave dhe përfshirje të palëve të interesuara.<sup>1</sup>

Me qëllim maksimalisht të shmanget ekspozimi ndaj infeksionit dhe transmetimit të tij, metoda për përfshirjen e palëve të interesuara dhe publikimi i informatave për këtë projekt përshtaten sipas rekomandimeve të lëshuara nga organizatat më relevante ndërkombëtare dhe kombëtare, si dhe faktorët relevantë që e modelojnë dhe e definojnë praktikën e mirë ndërkombëtare.

QRMV, më 03.11.2020<sup>2</sup>, solli Vendim për rekomandime preventive, masa kohore, masa të urdhëruara, protokolle të dedikuara, plane dhe algoritme për vendosjen e mbrojtjes së shëndetit të popullsisë nga sëmundja ngjitëse COVID-10 të shkaktuar nga virusi SARS-CoV-2, rastet dhe periudha kohore e zbatimit të tyre.

### 6.2 Strategjia e propozuar për informim dhe komunikim

Për qëllimet e Projektit, EMV do të shfrytëzojë metoda për përfshirjen e palëve të interesuara me qëllim të sigurojë komunikim të vazhdueshëm me të gjitha palët e interesuara, si dhe t'i bëjë të aderueshme për publikun të gjitha informacionet e nevojshme. EMV në bashkëpunim me Komunën e Kërçovës, por edhe komunitetet lokale që janë të përfshira nga Projekti, do të mundësojnë informim të rregullt të banorëve lokalë dhe subjektet afariste që

<sup>1</sup> Briefing-shënim për palët e interesuara (PR10) të BERZH – COVID-19; 15 prill 2020 (e qasshme në <https://www.ebrd.com/documents/environment/ebrd-covid19-briefing-note-stakeholder-engagement.pdf?blobnocache=true>)

<sup>2</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Numër 263/20 nga 04.11.2020

jetojnë ose punojnë në afërsi të Projektit, dhe atë në fazat zhvilluese të Projektit në veçanti në fillim të aktiviteteve ndërtimore dhe ndikimet gjithëpërfshirëse të aktiviteteve projektuese mbi to.

EMV dhe njësia për zbatimin e projektit (NJZP) do të zbatojnë konsultime publike dhe shpërndarjen e informacioneve që i reflektojnë çështjet kryesore relevante për Projektin.

Pakoja për Shpallje Publike të Projektit, do të përmbajë:

- Elaborat për VNMJ dhe miratim;
- Përmbledhje jo-teknike për vlerësim të mjedisit jetësor dhe aspektet sociale të Projektit;
- Ky Plan për përfshirjen e palëve të interesuara – (PPPI)
- Plani i Aksionit për mjedisin Jetësor dhe aspektet sociale (PAMJAS); dhe
- Formular për parashtrimin e ankesave të projektit (shih Shtojcën 1).

Dokumentet do të publikohen në ueb faqen zyrtare të EMV ([www.esm.com.mk](http://www.esm.com.mk)), dhe në ueb faqen e Komunës së Kërçovës. Këto do të përgatiten në gjuhën maqedonase dhe angleze dhe do të jenë të qasshme pas miratimit të tyre zyrtarë.

Version i shtypur nga Pakoja për shpallje publike do të jetë i qasshëm në hapësirat e EMV-së. Përveç kësaj, versioni i shtypur i dokumenteve do të jenë të qasshme edhe në hapësirat e zyrës lokale të Projektit, si dhe në vetë kantierin e ndërtimit – zyra e Kontraktorit, pas fillimit të punëve të ndërtimit.

Dokumentet do të jenë të qasshme në ueb-faqen e EMV-së dhe komunës në kohëzgjatje prej 30 ditësh kalendarike para shqyrtimit të Projektit nga ana e Bordit të drejtorëve të BERZH, dhe do të vazhdojnë të jenë publikisht të qasshme për kohëzgjatjen e Projektit.

Pas publikimit të dokumenteve të lartpërmendura, NJZP dhe EMV do të caktojnë dhe mbajnë së paku një takim për konsultime publike. EMV do t'i informojë të gjitha palët e interesuara për datën e saktë, kohën dhe vendin ku do të mbahet takimi dhe atë së paku 7 ditë më parë (sipas mundësisë edhe 2 javë), përmes publikimit në ueb faqen e EMV-së ([www.esm.com.mk](http://www.esm.com.mk)), komuna e Kërçovës ([www.kicevo.gov.mk](http://www.kicevo.gov.mk)) si dhe mediumet lokale (gazetat, portalet për gazeta në Internet). Publikimet për mbajtjen e takimeve publike do të theksohet edhe në lagjet fqinje të përfshira, ndërsa të cilat janë nën ndikimin e aktiviteteve projektuese me qëllim të përfshihet edhe popullsia lokale që jeton në këto vendbanime. Përveç kësaj, organizatat joqeveritare të shënuara në Shtojcën 3 të këtij PPPI do të kontaktohen dhe informohen direkt për takimin publik.

Të gjitha informacionet e qasshme dhe dokumentet për projektin do të shpallen publikisht së paku 2 javë para fillimit të takimit. Nëse nevojitet, do të organizohen edhe takime të ndara, me qëllim të sigurohet se pjesëmarrja e palëve të interesuara korrespondon me gjininë dhe origjinën etnike të të interesuarve.

Takimet do të synojnë sigurimin e informacioneve për publikun rreth fazës së ndërtimit dhe operimit të Projektit. Pjesëmarrësit do të mund t'i paraqesin mendimet e veta dhe vërejtjet në lidhje me Projektin, si dhe të propozojnë zgjidhje të mundshme për çështjet e diskutuara. Përfundimet nga takimi do të dakordohen gjatë kohës së takimit. Të gjitha komentet e arsyetuara dhe propozimet do të shqyrtohen dhe do të adresohen në mënyrë përkatëse. NJZP do të publikojë raport të shkurtër për të gjitha çështjet e ngritura relevante, duke përfshirë edhe shpjegimin për refuzim / pranim të propozimeve.

Përmbledhja nga kërkesa për përfshirjen e palëve të interesuara dhe publikimin e informacioneve të theksuara më lartë, gjendet më poshtë.

Tabela 2: Përmbledhje nga kërkesat për publikimin e informacioneve dhe përfshirjen e palëve të interesuara

|   | Aktiviteti   | Orari i punës/detaje të tjera  | Përgjegjësi |
|---|--|--|-------------|
| 1 | <p>Publikimi i dokumentacionit vijues për projektin e ueb-faqes së EMV-së dhe komunës së Kërçovës, në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ky PPPI</li> <li>• Elaborat për VNMJ dhe miratim i të njëjtës</li> <li>• Përmbledhje jo-teknike për vlerësimin e mjedisit jetësor dhe aspektet sociale të Projektit;</li> <li>• Formular për parashtrimin e ankesave të projektit</li> <li>• Plani i aksionit për mjedis jetësor dhe aspekte sociale</li> </ul> <p>Shtypje dhe ruajtje e versioneve të shtypura nga dokumentet në hapësirat e EMV-së, CTE dhe minierës REK Osllomej dhe komunës së Kërçovës.</p> | <p>Të gjitha informacionet në dispozicion dhe dokumentet për Projektin do të publikohen menjëherë pasi do të jenë të qasshme, por së paku 2 javë para takimit nga pika 2 më poshtë.</p>  | NJZP/EMV    |
| 2 | <p>Organizimi i së paku një takimi për konsultime me publikun sipas shpalljes së dokumenteve të lartpërmendura.</p> <p>Nxitje e dërgimit të propozimeve të shkruara dhe komenteve</p> <p>Sigurimi i qasjes në kohë deri te dokumentet para mbajtjes së çfarë do takimi (së paku 2 javë para ngjarjes)</p>  | <p>Palët e interesuara do të informohen për datën e saktë, kohën dhe vendin e mbajtjes së takimit, më së voni shtatë ditë para takimit (sipas mundësisë 14 ditë), përmes informimit nga ueb-faqja e EMV-së, mediumet lokale dhe tabelat e shpalljeve të komunës, si dhe vendbanimet e përfshira nga Projekti.</p> <p>OJQ dhe të shënuara në Shtojcën 4 nga ky PPPI do të kontaktohen drejtpërsëdrejti dhe do të informohen për takimin publik.</p> | NJZP/EMV    |
| 3 | <p>Organizimi i takimeve individuale të konsultimit</p>  | <p>Sipas nevojave ose me kërkesë të EMV-së, Komuna, ose cila do qoftë grup e identifikuar e palëve/individëve të interesuara</p>   | NJZP/EMV    |

|   | Aktiviteti   | Orari i punës/detaje të tjera                         | Përgjegjësi              |
|---|--|---|--------------------------|
| 4 | Dokumentimi i të gjitha mendimeve, vërejtje dhe zgjidhje të mundshme në lidhje me Projektin, të cilat janë ngritur nga palët e interesuara gjatë takimeve konsultuese, si dhe përgjigje përkatëse për të njëjtat                                 | Aktual  | NJZP/EMV                 |
| 5 | Publikimi i informacioneve për vëllimin, orarin e kohës dhe kohëzgjatjen e punëve të planifikuara të ndërtimit, si dhe ndërprerje të pritura dhe mospërputhje, përmes ueb-faqes së EMV-së dhe komunat e përfshira                                | Dy javë para fillimi të punëve të ndërtimit të EMV-së | NJZP/EMV                 |
| 6 | Publikimi i informacioneve për aktivitetet projektuese, si dhe karakteristikat ekologjike dhe sociale të Projektit përmes ueb-faqes së EMV-së dhe komunës së përfshirë, por edhe të lokacioneve të dukshme përmes komuniteteve të prekura lokale | Në çdo dy muaj gjatë kohës së fazës së ndërtimit      | NJZP/EMV dhe Kontraktori |

Për kohëzgjatjen e ciklit jetësor të Projektit, EMV, NJZP dhe Kontraktori do të vazhdojnë të bashkëpunojnë me palët e interesuara, dhe ky PPPI do të përditësohet para fillimit të aktiviteteve të ndërtimit me qëllim të përfshihen të gjitha pyetjet që janë ngritur gjatë konsultimeve të mbajtura në fazën para-ndërtimore. Çështjet e ndritura gjatë kohës së fazës ndërtimore do të dokumentohen, ndërsa përgjigjet e dhëna përmes mekanizmave të përshkruara në këtë PPPI.

Tabelat e informimit do të vendosen nga ana e Kontraktorit në hyrjen e fushës projektuese dhe në çdo lagje fqinje (përveç nëse veçmë ekzistojnë tabela për njoftim të komunitetit dhe këto mund të përdoren), dhe do të shërbejnë si mjet/kanal mediatik për komunikim me banorët lokal. Do të përfshihen edhe informacione për Mekanizmin e ankesave.

Kontraktori do të sigurojë kantierin e ndërtimit para fillimit të aktiviteteve të ndërtimit me shenjat përkatëse dhe kujdes për kantierin e ndërtimit.

## 7 BURIME DHE PËRGJEGJËSI PËR ZBATIMIN E AKTIVITETEVE PËR PËRFSHIRJEN E TË INTERESUARVE

Në kuadër të EMV-së do të formohet Njësi për Zbatimin e Projektit (NJZP). Ky organ do të jetë përgjegjës për zbatimin e Projektit, duke përfshirë edhe zbatimin e këtij PPPI. Njësia për zbatimin e projektit është përbërë nga Udhëheqësit e NJZP-së (të shënuar nga udhëheqësja e Oslomejit), Menaxheri projektues i eletranës fotovoltaike si dhe tre anëtarët e NJZP-së (të shënuara nga EMV).

Për shkak të realizimit efektiv të aktiviteteve të planifikuara për përfshirjen e palëve të interesuara, NJZP do të përdorë mjete të veta financiare. Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për shpenzimet e veta të bëra në emër të aktiviteteve të nevojshme për përfshirjen e palëve të interesuara për Projektin.

Për zbatimin e këtij PPPI do të përcaktohet një person përgjegjës nga ana e NJZP-së, i cili në të njëjtën kohë do të obligohet edhe për komunikimin me komunitetet. Informacionet e kontaktit të saj/tij do të përditësohen sipas nevojës.

Të gjithë kontraktorët përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve specifike të projektit duhet t'i zbatojnë rregullat relevante nga ky PPPI (shih Kapitullin 6). Kërkesat e lidhura me Mekanizmin e ankesave (shih Kapitullin 8) do të theksohen në dokumentacionin e tenderit, si dhe kontratat që janë të nënshkruara me kontraktorët.

## **8 MEKANIZMA TË ANKESAVE**

EMV, në emër të këtij Projekti do të krijojë procedurë për ankesa, ndërsa të gjitha palët e interesuara do të informohen për Mekanizmin e ankesave, kontakt personat nga EMV që do të përgjigjen për zbatimin e mekanizmit, si dhe format për parashtrimin e ankesave.

Fletushkat e ankesave dhe forma e ankesave (Shtojca 1) për Projektin do të jenë të qasshme në ueb faqen zyrtare të EMV-së dhe në komunën e përfshirë të Kërçovës, në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Kopjet e shtypura (gjithashtu në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe) gjithashtu do të jenë të qasshme në hapësirat kryesore të EMV-së në Osllomej (TPP Osllomej), si dhe në hapësirat e komunës së Kërçovës. Nëse Komuna merr ankesa (në formë të shtypur ose përmes e-postës) ata do të dorëzojnë deri te EMV në afat prej 3 ditësh pas pranimit. Kështu, të gjitha komentet të dhëna nga palët e interesuara mund të njoftohen personalisht, me telefon ose në formën e parashikuar të ankesave.

Formulari i ankesave mund të dorëzohet edhe te Kontraktori gjatë kohës së punimeve ndërtimore. Fletushka dhe formulari i ankesave do të jenë të qasshme në vetë kantierën e ndërtimit në formë të shtypur në gjuhën maqedonase dhe shqipe, ndërsa fletushkat do të publikohen në tabelën e shpalljes të kantierit të ndërtimit me qëllim të jenë të dukshme për opinionin dhe palët e interesuara. Kontraktori është i detyruar të gjitha ankesat e pranuar t'i përcjellë deri te personi për kontakt të projektit në NJZP.

Të gjitha ankesat do të shënohen në Regjistrin e ankesave (Shtojca 3) ku do të vërtetohen në periudhën prej 7 ditësh. Palët e interesuara që parashtrajnë ankesa do të informohen nga ana e EMV-së për masat e propozuara korrekte dhe aktivitete e mara në afat prej 15 ditësh kalendarike pas pranimit të ankesës. Nëse EMV nuk ka mundësi të zgjidh problemin ose nëse nuk nevojitet veprim, EMV do të jep arsyetim përkatës dhe arsyetim të parashtruesit të ankesave në cilën mënyrë më tej do të veprojnë nëse nuk është i kënaqur me rezultatin. Personat që parashtrajnë ankesa mund të kenë interes edhe për mekanizma të tjera juridik në pajtim me ligjet nacionale dhe rregulloret.

NJZP do të ndjekë mënyrën me të cilën veprohet me ankesat dhe do të udhëheqë evidencë për ankesat e arritura (në Regjistrin e ankesave shih Shtojcën 3) duke i përfshirë edhe ato të dorëzuara nga Kontraktori. Regjistri do të shërbejë si bazë për plotësimin e raporteve për udhëheqje me ankesa të cilat do të përfshihen në Raportet vjetore për mjedisin jetësor dhe aspektet sociale për Bankën (shih Kapitullin 9).

NJZP do t'i publikojë dhe rregullisht do t'i përditësojë të gjitha dokumentet relevante dhe procedurat e ankesave në ueb-faqen e tyre, por do të sigurojë kopje nga Formulari i ankesave për Komunën e Kërçovës. NJZP do të sigurojë informacion kthimi drejt të gjitha palëve të interesuara të cilët e kanë plotësuar formularin e ankesave përmes e-postës ose përmes postës. Gjithashtu, NJZP do të komunikojë me të gjithë faktorët relevant dhe do t'i informojë për çfarë do lloj ndryshimi në dinamikën e Projektit, me çka të gjitha përditësimet do të publikohen në

ueb-faqen e EMV-së dhe komunës, njëkohësisht do të sigurohen fletushka në komunitetet lokale nga fushat e përfshira të Projektit.

Në çdo kohë, personat që kanë parashtruar ankesa mund të kërkojnë mjete të tjera juridike në përputhje me kornizën ligjore të RMV-së, duke përfshirë edhe ankesën formale të gjyqit.

Mekanizmi i veçantë i ankesave do të jetë i qasshëm për punëtorët.

Informacione kontakti për pyetje dhe ankesa:

Drejtuar: Kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm dhe

Julija Simjanovska – Mjedisi Jetësor

Adresa: 11 Tetori rr. 9, Shkup

Tel/Fax: + 02 3149 121

Tel/Fax: + 02 3149 121

E-mail: [contact@elem.com.mk](mailto:contact@elem.com.mk)

[julija.v.simjanovska@elem.com.mk](mailto:julija.v.simjanovska@elem.com.mk) (në cc)

## 9 MONITORIMI DHE RAPORTIMI

EMV së bashku me autoritetet lokale nga komuna e Kërçovës do të jenë përgjegjës për monitorim të aktiviteteve për zbatimin e NJZP-së në fushën e përfshirjes së palëve të interesuara të Projektit, si dhe kanalet për komunikim, në veçanti me personat e përfshirë të projektit (PPP).

Me qëllim ta përmbledh procesin e angazhimit të palëve të interesuara, NJZP do të përgatisë një raport të veçantë monitorimi (Raport i aktiviteteve për përfshirjen e palëve të interesuara), ku raporti i parë duhet të punohet tre muaj pas fillimit të aktiviteteve ndërtimore dhe do të vazhdojë të përpunohet në bazë gjysmë-vjetore, deri te përfundimi i punimeve të ndërtimit. Pas përfundimit të Projektit, NJZP do të përgatisë një raport vjetor për monitorim gjatë fazës operative. Raportet e monitorimit duhet t'i përmbajnë këto informacione:

- Takime konsultimi me palët e interesuara (vendi, koha, pyetje diskutimi, masa për zbutje të siguruara nga NJZP)
- Ankesa të konstatuara gjatë periudhës ku përpunohet raporti (dhe të gjitha informacionet e hollësishme për të)
- NJZP do të njoftojë BERZH për aktivitetet për përfshirjen e palëve të interesuara (në nivel vjetor)
- Secili Raport i aktiviteteve për përfshirjen e palëve të interesuara për Projektin do të publikohet në ueb-faqen e EMV-së për shqyrtime publike dhe komente të mëtejme.

NJZP do të ftojë OJQ/OQ lokale të interesuara për realizimin e monitorimit të jashtëm, me qëllim të mbikëqyrë zbatimin e aktiviteteve të PPPI-së.


Indikatorët që duhet të ndjeke ngjatë realizimit të PPPI-së janë:

- Të gjitha palët e interesuara njoftohen para fillimit të aktiviteteve të Projektit.
- Shpërndarja e informacionit – disponueshmëri dhe qasje e dokumenteve të projektit; frekuenca e shpërndarjes së informacioneve, informacioneve të arritura për palët e interesuara.
- Realizimi i aktiviteteve të planifikuara – numri i shkallës së pjesëmarrjes nga ana e grupeve specifike të

palëve të interesuara.

- Numri i grupeve të rrezikuara të identifikuara dhe të njoftuara.
- Procesverbal nga takimet.
- Aktivitete të porositura për korrigjim.
- Numri dhe lloji i ankesave.
- Pajtueshmëri me mekanizmin e ankesave – Raporte të kompletuara në Regjistrin e ankesave: Shtojca 3.
- Numri i ankesave të përsëritura.

Shtojca






**SHTOJCA 1: FORMULARI I ANKESAVE**

|  |   |
|--|---|
| <b>Numër referimi:</b>   |   |
| <b>Emri dhe mbiemri i plotë:</b><br>(mund të mbeteni anonim/e, nëse nuk dëshironi identiteti juaj të zbulohet pa pëlqimin tuaj)  |   |
| <b>Informacione kontakti:</b><br>Ju lutemi të shënoni në cilën mënyrë dëshironi t'ju kontaktojme (postë, telefon, e-postë).  | <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Përmes postës:</b> (Ju lutemi shënoni adresën postare)<br/>_____</li><li>• <b>Telefoni:</b> _____</li><li>• <b>e-postës:</b> _____</li></ul>                                 |
| <b>Gjuhë e preferuar e komunikimit</b>   | <input type="checkbox"/> Maqedonase<br><input type="checkbox"/> Tjetër: _____   |
| <b>Përshkrimi i incidentit/ankesa:</b> Çfarë ndodhi? Ku ndodhi? Kujt i ndodhi? Cili është rezultati i problemit?   |   |
| <b>Data e incidentit / ankesa</b>  | <input type="checkbox"/> Incident i njëhershëm / ankesë (data _____ )<br><input type="checkbox"/> Ka ndodhur më shumë se një herë (sa herë)? (_____)<br><input type="checkbox"/> Aktualisht (problemi ndodh aktualisht) |
| <b>Çfarë dëshironi të bëhet që të zgjidhet problemi?</b>   |   |
|  |   |
| <b>Nënshkrimi:</b>   | <b>Data:</b>  |
| Ju lutemi ktheni këtë formular në:<br>Zyrën e menaxherit kryesor dhe<br>Julia Simjanovska – Mjedisi Jetësor<br>E-mail: <a href="mailto:contact@elem.com.mk">contact@elem.com.mk</a> ;<br><a href="mailto:julija.v.simjanovska@elem.com.mk">julija.v.simjanovska@elem.com.mk</a> (në cc)<br>Tel./Fax: + 389 (0)2 3149 121 | Adresa: Elektranat e Maqedonisë së Veriut<br>Rr. 11 Tetori, nr. 9, 1000 Shkup<br>Republika e Maqedonisë së Veriut   |

SHTOJCA 2: PROCEDURA E ANKESAVE NGA PROJEKTI



Zbatimi i ankesave (me gojë ose me shkrim)

Njoftimi për pranim, më së voni 7 ditë

#### **AKSIONI I NEVOJSHËM**

**Aksion urgjent i mjaftueshëm të plotësojë personin që ka parashtruar ankesa**

Informo personin që ka parashtruar ankesa për aksionet e propozuara korrekte dhe vërtetimi i kënaqësisë nga aksioni i propozuar

**Pa aksion**

**Regjistro datën në Regjistrin e ankesave**

Identifiko nëse është i nevojshëm aksioni afatgjatë korrekte

Informo personin që ka parashtruar ankesë për aksionet e propozuara korrekte ose shpjego pse aksioni nuk është i nevojshëm në periudhën prej 15 ditësh

Zbato aksionin korrekt dhe këtë ndjeke

Ndiqe deri te zbatimi i suksesshëm i aksionit korrekt

**Shëno datën.**

**Shëno rastin:**

#### **SHTOJCA 3: REGJISTËR I ANKESAVE**

Regjistri i ankesave nga Projekti, i cili udhëhiqet në format digjital dhe paraqitje tabelare, është e nevojshme t'i përmbajë informacionet vijuese:

#### **FUTJE**

Iniciator:

Lokacioni i vendbanimit:

Lloji i problemit

Emri dhe mbiemri

Informacione kontakti

Data e futjes:

Vërtetim për pranim të ankesës

Problemi:

Përshkrimi i problemit:

Vendim i propozuar

Aktivitetet që duhet të merren për zgjidhjen e problemit

**DALJE**

Data e mbylljes

Përcjellje e ankesës

Rezultate nga veprimet e marra

Përsëritje Po/Jo.

**SHTOJCA 4: INFORMACIONE KONTAKTI I PALËVE TË IDENTIFIKUAR TË INTERESUAR**

| Emri i OJQ/Pala e interesuar  | Informacione kontakti  |
|---|--|
| Shoqata Ekologjike e Maqedonisë (MED)                                 | Vlladimir Nazor 10, 1000 Shkup<br>Tel: (02) 2402 773,<br>Fax: (02)2402 774<br>Mob: 078 393 436<br><a href="mailto:contact@mes.org.mk">contact@mes.org.mk</a>                 |
| Lëvizja e ambientalistëve të Maqedonisë (DEM)                         | Vasil Gjorgov 39, baraka 6, 1000 Shkup<br>Tel: (02) 3220-520<br><a href="mailto:dem@dem.org.mk">dem@dem.org.mk</a><br><a href="mailto:ruska@dem.org.mk">ruska@dem.org.mk</a> |
| Qendra për Hulumtime Mjedisore dhe Eko-ndërgjegjësim të informacionit | Bul. 11 Tetori 125/12, Shkup<br>Tel: (02) 3217-247<br>Fax: (02) 3217-246<br>Mob: 072 726-104<br><a href="mailto:info@ekosvest.com.mk">info@ekosvest.com.mk</a>               |
| Front 21/42   | Orce Nikollov 83A, 1000 Shkup<br>Tel/Fax: (02) 3122-546<br>Mob: 075 433-231<br><a href="mailto:contact@front.org.mk">contact@front.org.mk</a>                                |
| Qendra e Gjelbër e Maqedonisë   | Kosta Novaković 1A/19, 1000 Shkup<br>Tel/Fax: (02) 6132-432<br>Mob: 078 205 217<br><a href="mailto:zeleni@zeleni.org.mk">zeleni@zeleni.org.mk</a>                            |
| Shoqata për studimin dhe mbrojtjen e shpendëve në Maqedoni            | FNM- Gazi Baba PN, 1000 Shkup<br>02/3117-055; 078/254-736<br><a href="mailto:brankom@ukim.edu.mk">brankom@ukim.edu.mk</a>  |
| Shoqata për mbrojtjen e bufëve  | Jurij Gagarin 28-5/3, 1000 Shkup<br>070/999-859<br><a href="mailto:macedonian.owl.trust@gmail.com">macedonian.owl.trust@gmail.com</a>  |